

VENDIM
Nr. 352, datë 19.4.2017

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“SISTEMIM, ASFALTIM-NDRIÇIM I AKSIT RRUGOR, BLOKU 11.2 HA, NË LAGJEN
“BESËLIDHJA””, FAZA E TRETË, BASHKIA E LEZHËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Sistemim, asfaltim-ndriçim i aksit rrugor, blloku 11.2 ha, në lagjen “Besëlidhja””, faza e tretë, Bashkia e Lezhës.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Lezhës.

3. Pronari i pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë “truall”, me sipërfaqe 62 (gjashtëdhjetë e dy) m², “ndërtesë”, me sipërfaqe 71.24 (shtatëdhjetë e një pikë njëzet e katër) m², si dhe “njësi”, me sipërfaqe 62 (gjashtëdhjetë e dy) m², me vlerë të përgjithshme të shpronësimit prej 9 751 976 (nëntë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 9 751 976 (nëntë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Lezhës, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia e Lezhës.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë e Lezhës të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Regjistrimi i ri i pasurive: “truall”, me sipërfaqe 62 (gjashtëdhjetë e dy) m², “ndërtesë”, me sipërfaqe 71.24 (shtatëdhjetë e një pikë njëzet e katër) m², si dhe “njësi”, me sipërfaqe 62 (gjashtëdhjetë e dy) m², për realizimin e projektit “Sistemim, asfaltim-ndriçim i aksit rrugor, blloku 11.2 ha, në lagjen “Besëlidhja””, faza e tretë, të bëhet në favor të Bashkisë së Lezhës.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lezhë dhe Bashkia e Lezhës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

LISTA E EMËRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRNËSOHEN PËR EFEKT TË REALIZIMIT TË PROJEKTTIT SISTEMIM, ASFALTIM-NDRIÇIM I AKSIT
RRUGOR BLOKU 11.2 HA NË LAGJEN BESËLIDHJA", FAZA E TRETË, BASHKIA LEZHË

Nr.	Pronari	Nr. i pasurisë	ZK	Truall			Ndërtesë			Njësi shërbimi			Vlera e përgj./lekë	Lloji i dokumentit të pronës
	Emri Mbiemri			Sip./m ²	Çmimi/lekë/m ²	Vlera në lekë	Sip./m ²	Çmimi në lekë/m ²	Vlera në lekë	Sip./m ²	Çmimi/lekë/m ²	Vlera në lekë		
1	Mark Doda	4-53/N 4/53+1-1	8632	62	8511	527682	71.24	56000	3 989 440	62	84433.13	5234854	9 751 976	Konfirmim nga ZRPPP
	Totali												9 751 976	